

Adresimi i diskriminimit të shumëfishtë përmes litigimit strategjik

Në kuadër të projektit “Adresimi i diskriminimit të shumëfishtë përmes litigimit strategjik”, zbatuar nga QNL me mbështetjen e Civil Rights Defenders, (CRD), janë paraqitur pranë institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi informacione dhe/ose ankesa për çështje që kanë patur në qendër të tyre diskriminimin e shumëfishtë.

Një nga këto çështje të adresuara nga Qendra në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC) ka qenë ajo mbi segregimin në shkollën “Avdyl Avdia”, Moravë, Berat, shkollë vartëse në vartësi të shkollës 9 vjeçare "Shaban Sollaku", Moravë. *Në këtë shkollë mësojnë 45 nxënës Rom, në dy klasa të bashkuara, kl. I-V, II-IV, dhe I, III, V. Shkolla vartëse përbëhet pothuajse 100% nga nxënës rom. Numri i fëmijëve rom e veçanërisht i vajzave, që përfundojnë shkollën vartëse “Avdyl Avdia” dhe vazhdojnë studimet në shkollën 9 vjeçare "Shaban Sollaku" është i kufizuar. Kjo situatë segregimi për shkak të racës përbën një shkelje të së drejtës së komunitetit rom për tu arsimuar, në një arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor. Fëmijët e 2-3 familjeve jo rome të zonës, nuk mësojnë në shkollën vartëse të lartpërmendur por në shkolla të tjera, që ofrojnë standarde më të larta edukimi.*

Forma e vënies në lëvizje të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë *paraqitja e një informacioni të besueshëm*, bazuar në nenin 32 “Kompetencat”, pika c të ligjit nr.10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke e konsideruar si një mjet më të qëndrueshëm dhe si një formë më efektive dhe të shpejtë për litigimin strategjik.

U argumentua se segregimi i nxënësve për shkak të racës ka sjellë mungesë ndërveprimi të fëmijëve Rom me ata jo Rom, ka ndikuar në cilësinë e arsimimit të tyre, në braktisjen e shkollës sidomos nga vajzat dhe do ndikojë në veçimin e minoritetit rom në të ardhmen, etj.

Në rastin e *diskriminimit për shkak të gjinisë*, u pretendua nga QNL se numri i vajzave rome që braktisin shkollën ishte i lartë, dhe i përballte ato me vështirësi në tregun e punës dhe jetën sociale në tërësi, apo me probleme të tjera si martesat në moshë të hershme, mentaliteti i prindërve, etj.

Pas ndjekjes *ex officio*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vendimin nr. 176, datë 16.12.2015, vendosi:

- Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, në fushën e arsimit, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Berat, për krijimin e situatës së segregimit dhe veçimit të nxënësve rom pranë shkollës vartëse “Avdyl Avdia” në lagjen Stan, Moravë, Berat. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk gjeti diskriminim për shkak të gjinisë.
- Marrjen e masave të nevojshme nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Drejtorisë Arsimore Rajonale Berat, për ndalimin e gjendjes së segregimit të nxënësve rom pranë shkollës vartëse “Avdyl Avdia” në lagjen Stan Moravë Berat.

- Marrjen e masave të menjëhershme nga DAR Berat, për sigurimin e transportit falas për të transportuar nxënësit e shkollës “Avdyl Avdia”, për në shkollën kryesore, si dhe një përfaqësues të komunitetit, që ti shoqërojë nxënësit.

Një zhvillim pozitiv ka ndodhur në lidhje me nxënësit e shkollës vartëse “Avdyl Avdia”, në Moravë, Berat, në vijim të rekomandimeve të KMD-së.

Në përgjigje të kërkesës së DAR Berat mbi verifikimin/miratimin për disa linja, Këshilli i Bashkisë Berat me vendimin nr.84, datë 29.07.2016, “Për miratimin e linjave të transportit të mësuesëve dhe nxënësve “, i ndryshuar me vendimin nr. 95, datë 16.09.2016 *miratoi linjën e transportit Stan-Moravë, duke siguruar transportin falas për të gjithë nxënësit e shkollës “Avdyl Avdia” ose kompensimin e biletës së udhëtimit për ta.*

Ky vendim pritet të zbatohet së shpejti. Zbatimi i tij kërkon edhe marrjen e masave të tjera si: programe këshillimi për prindërit, programe trajnimi për stafin e shkollës së integruar “Shaban Sollaku”, biseda të hapura me nxënësit e shkollës së integruar “Shaban Sollaku” me qëllim trajtimin e barabartë të nxënësve rom të ardhur nga shkolla e segreguar “Avdyl Avdia”, etj.